

Data 08.11.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

FV kamera sigurie ne hapësirat publike te qytetit Durres (loti I)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi

CPV: 35125300-2 Kamera sigurie dhe 44523200-4 montime

VLERA E FONDIT LIMIT: 16,666,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 1 (një muaj)

Garancia per mbulimin te difekteve, nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr. 7974 datë 29.09.2022 dhe nr.474 datë 29.09.2022. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të bashkise të vitit 2022-2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktura, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Komisioni llogariti gjëndjen e shumës së vëne në dispozicion sipas **Vendimit të Këshillit Bashkiak** Nr 158, Datë 23.12.2021 për FV kamera sigurie ne hapësirat publike te qytetit Durres (loti I)

Grupi u mbështet: Në hetimin e tregut vendas. Në Përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato në një Tabelë Komplekse të Grumbullimit të Zërave te preventivit bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës.

Afati i realizimit të punimeve është 1 (një muaj)

Garancia per mbulimin te difekteve, nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloraritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 16'000'000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe mbeshtetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 32'000'000 lekë.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçense profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni etj

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.* Keto licenca janë të lidhura me natyrën dhe llojin e procedurës së prokurimit dhe tregojnë profesionalizmin dhe aftësinë tekniko-profesionale të operatoreve ekonomik për të kryer instalimet e nevojshme.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Minimumi 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhim Projektesh PMP ose ekuivalente (per te cilin O.E duhet te certifikaten perkatese dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)
- b. Minimumi 1 (nje) inxhinier elektronik (per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)
- c. Minimumi 1 (nje) inxhinier telekomunikacioni (per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)
- d. Minimumi 1 (nje) inxhinier elektrik (per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)
- e. Minimumi 1 (nje) specialist TIK (per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)
- f. Minimumi 1 (një) inxhinier të pajisur me çertifikatë Lead Auditor për "Sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Informacionit"(ISO:27001:2013) (per te cilin O.E duhet te paraqesi certifikaten perkatese dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)
- g. Minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike ose teknik elektronik, kjo e vërtetuar me listpagesat e 3-muajve të fundit sipas kodit perkates te profesionit
- h. Minimumi 3 (tre) punonjës te certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve te kamerave (per te cilin O.E duhet te paraqesi certifikaten perkatese dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",*

Kerkesat e mesiperme i sherbejne AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka stafin e nevojshem per te realizuar me sukses implementimin e kontrates brenda afateve me dhe cilesine e kerkuar. Inxhinieret dhe tekniket e kerkuar jane personat e drejperdrejte qe do te angazhohen nga O.E ne instalimin e pajisjeve , konfigurimin e tyre dhe integrimin ne rrjetin ekzistues qe ka bashkia Durres.

Kerkesat dhe specializimet e stafit qe kerkohen jane te lidhura ngushte me natyren e kontrates qe prokurohet.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Kontrate pune, CV, diplomat / certifikatat per kualifikimet e kerkuara, si edhe te rezultojne ne listepagesat e shoqerise.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar.kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve dhe kontrata pune. diplomat / certifikatat per kualifikimet e kerkuara, si edhe te rezultojne ne listepagesat e shoqerise.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Ndërsa për punëtori të thjeshtë, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 13 persona**, në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

- Certificate cilesie sipas standartit ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- Certificate cilesie sipas standartit SSH ISO/IEC 20000-1:2018 Teknologji Informacioni - Menaxhimi i shërbimit - Pjesa 1: Kërkesat e sistemit të menaxhimit të shërbimit, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit ISO 14001:2015, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit SSH EN ISO/IEC 27001:2017 Teknologjia e informacionit - Teknikat e sigurisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit - Kërkesat (ISO / IEC 27001: 2013, duke përfshirë Cor 1: 2014 dhe Cor 2: 2015), ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit Standartit **ISO 45001:2018 per** Sistemet e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne vendet e punes.
- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 39001:2012 per sistemet e menaxhimit te sigurise rrugore.
- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 50001:2011 per sistemet e menaxhimit te energjise.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata ne perputhje me zerat qe ka marre persiper te kryeje.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u nisur nga kërkesat e cilësisë së mallrave që do të furnizohen si dhe punimet komplekse që duhet të kryhen për të cilat duhet të jepet garanci. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë

dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Vendosja e ketyre certifikatave është kryer pas konsultimit dhe bazuar në Katalogun e Standarteve Shqiptare për vitin 2021.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës së artikujve sipas tabelës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të përcaktojë periudhën e vlefshmerisë së tij.

Pershkrimi
NVR (Network Video Recorders) me 128 kanale
Kamera e jashtme me Ngjyra 24/7
Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine)
Kamera e Jashtme me panel diellor
Kamera për numerimin e njerezve
Kamera panoramike profesionale PTZ
Kamera e jashtme distance e larget

Switch POE me 5 Porta
Video Wall 3X2 + Video Procesor

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin 40, pika 5/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë prodhues ose kanë mundësinë të marrin artikujt e ofruar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Gjithashtu nëpërmjet këtij kriteri operatorët ekonomikë dëshmojnë se ofrojnë një produkt cilësor në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Ky kriter është i gërshetuar edhe me kriteret e tjera të kësaj procedure për furnizimin me mallra cilësore që do të shërbejnë për rritjen e sigurisë publike gjatë vitit 2022, por sidomos gjatë sezonit turistik.

2.4.2 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për listën sipas pikës 2.4.1, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin 40, pika 6/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dorëzojnë ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi për të treguar se janë në përputhje me specifikimeve teknike të kërkuara.

2.4.3 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të produkteve sipas listës së mëposhtme:

2 Pershkrimi
NVR (Network Video Recorders) me 128 kanale
Kamera e jashtme me Ngjyra 24/7
Kamera e Jashtme ANPR (Lexues Targe Makine)

Kamera e Jashtme me panel diellor
Kamera per numerimin e njerezve
Kamera panoramike profesionale PTZ
Kamera e jashtme distance e larget
Switch POE me 5 Porta
Video Wall 3X2 + Video Procesor

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Nga Autoriteti Kontraktor janë përzgjedhur që të kërkohen mostra për ato mallra që kanë konsum/përdorim më të përgjithshëm, që kanë premisa të dëmtohen/digjen më shpejt dhe që nevoja për to është në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme.*

2.4.4 Operatori ekonomik do të paraqese nje deklarate te garancise me afat 2 dy vjecare per pajisjet objekt te kesaj procedure prokurimi.

2.4.5 Operatori ekonomik do të paraqese nje deklarate qe pas kryerjes se instalimit te pajisjeve dhe konfigurimit te tyre, do të riparoje defektet e mundshme gjate periudhes se garancise brenda afateve te percaktuara ne kontrate, si dhe merr persiper te realizoje te pakten 3 seanca trajnimi te ndryshme me stafin qe do te perdore pajisjet objekt te kesaj procedure prokurimi.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al
Ueb-faqe	www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur Punë

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-49175-11-08-2022

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “FV kamera sigurie ne hapësirat publike te qytetit Durres (loti I)”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 35125300-2 Kamera sigurie dhe 44523200-4 montime

6. Fondi limit: **16,666,666** (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 1 (një muaj)

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 24.11.2022 Ora 10.00

Njësia e Prokurimit